

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE KOLEGJI PRIVAT PROFESIONAL I DURRESIT shpk

1. ARTAN LILAMANI, atesia Hajdar, dtl. 03.02.1964, banues ne Kavaje, L. 6, Rr. "M.Babamusta", nr. 87, identifikuar me dokumentin e identitetit nr. personal G40203107B.

I cili ka themeluar shoqerine:

Baza ligjore mbeshtetese eshte Ligji nr. 80/2015 "Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republiken e Shqiperise"; VKM nr. 370/2017 "Per organizimin dhe funksionimin e Kolegjit Profesional te Larte"; Ligji nr. 9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 1

ARSIMIMI, QELLIMI

Kolegji afirmon se, te drejten per te ndjekur arsimin e larte e kane te gjitha ata individe qe kane perfunduar me sukses arsimin e mesem dhe te cilet plotesojne kriteret e pranimit, te percaktuara nga kuadri ligjor ne fuqi dhe nga institucioni i arsimit te larte.

Arsimi u garantohet ne keto programe studimi edhe individeve, te cileve u njihet kjo e drejte me ligje te vecanta. Kolegji Profesional i Durresit, eshte i organizuar e formen e institucionit te arsimit te larte jo publik, me qellim pergatitjen e profesionisteve me aftesi praktike.

Shoqeria eshte person juridik shqiptar, veprimtaria e te ciles rregullohet nga ligji, statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

EMRI, EMERTIMI

Shoqeria ka emrin e saj: KOLEGJI PRIVAT PROFESIONAL I DURRESIT
Shoqeria do te perdore emertimin tregtar: KPPD

Neni 3

SELIA

Selia eshte ne Shqiperi, Durres, L. 17, Rr. Stef Kaculini, Godina nr. 36, perballe Kishes Katolike
Selia e shoqerise mund te transferohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

AFATI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka si objekt te aktivitetit:

- Organizimi, zhvillimi i progameve te arsimit te larte me orientim profesional, veprimtarive krijuese, trajnuese e profesionale, inovacionit dhe praktikave me te mira profesionale.
- Bashkepunimi me institucione te tjera te arsimit te larte, institucione publike dhe biznese private per zhvillimin e aktivitetit ne te mire te studenteve e tregut te punes.

Neni 6

KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne shumen 100.000 leke, qe ndahet ne kontributet e Ortakeve themelues, ku: Artan Lilamani zoteron 1 kuote, me pjesemarrje 100% ne kapital me vlere 100.000 leke.

Kapitali fillestar dhe kontributet qe perbejne ate akordohen ne Para (leke).

ORTAKET themelues perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se nenshkruar te kapitalit themeltar.

Neni 7 STRUKTURA

Kolegji eshte i organizuar me strukture ne dy departamente.

1. Departamenti i Teknologjise dhe Informacionit (DTI) me keto programe: Specialist Rrjetesh Kompjuterike; Web Design

2. Departamenti i Shkencave Teknikke (DSHT) me programe: Agroturizem; Teknik Elektrik; Teknik per Servis Automjesh; Teknik i Impjanteve Industriale; Teknik i Impjanteve te Gazit

Departamenti eshte njesi e zhvillimit te mesimdhenies dhe trajnimit dhe eshte pergjegjes per programet e studimit qe ofron.

Departamenti nxit, programon, bashkerendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarine e mesimdhenies dhe ate te trajnimit.

Neni 8 PERBERJA

Çdo Departament ka ne perberje 5 anetare, te punesuar me kohe te plote si personel mesimdhenes, nga te cilet, te pakten, dy pedagogje me grade shkencore ose titull akademik per çdo departament.

Departamenti mund te kete ne perberje edhe personel ndihmes mesimdhenes.

Drejtuesi i departamentit i perket kategorise "Profesor" ose ka graden shkencore "Doktor" ("PHD"), te fituar prane universiteteve te vendeve anetare te OECD-se ose BE-se.

Ne mungese te autoriteteve drejtuese me kete titull/grade shkencore dhe per efekt te perfaqesimit, kategoria e tyre mund te zbrese, sipas percaktimeve te bera ne statutin e institucionit.

Neni 9 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese jane Senati Akademik, Asambleja e Personelit Mesimdhenes dhe Bordi i Administrimit.

Senati Akademik perbehet nga jo me pak se pese anetare dhe Rektori eshte kryetari i Senatit Akademik.

Anetaret e Senatit Akademik te kolegjit i perkasin kategorise "Profesor" ose kane graden shkencore "Doktor" ("PHD"), te fituar prane universiteteve te vendeve anetare te OECD-se ose BE-se.

Ne mungese te autoriteteve drejtuese me kete titull/grade shkencore dhe per efekt te perfaqesimit, kategoria e tyre mund te zbrese, sipas percaktimeve te bera ne statutin e institucionit.

Organ drejtues administativ eshte Bordi i Administrimit te kolegjit dhe perbehet nga jo me pak se tre anetare, te punesuar me kohe te pjesshme. Anetaret e Bordit te Administrimit zgjidhen sipas percaktimeve ne statutin e institucionit.

Neni 10 AUTORITETET DREJTUESE

Autoritetet drejtuese jane Rektori, Drejtuesi i departamentit dhe Administratori i kolegjit.

Rektori ose drejtori mban titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar".

Administratori i Kolegjit emerohet nga Bordi i Administrimit.

Administrator emerohet personi qe zoteron arsim te larte, se paku ne nivelin "Master i Shkencave" ne fushen e drejtesise ose te ekonomise dhe pervoje pune, se paku pese vjet, ne keto fusha.

Administratori emerohet me afat 5 vjet me te drejte riperteritje.

Neni 11 PROGRAMI MESIMOR

Kolegji ofron programe te akredituara qe zgjasin dy vite akademike, me 120 kredite (ECTS), per te cilat do te leshohet certificate ose diplome profesionale.

Neni 12 VITI FINANCIAR

Viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 13
DISPOZITE KALIMTARE

Statuti shyrtohet e miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Amdinistrimit dhe pasi ndiqen procedurat ligjore parashikuar ne nenin 33 te ligjit nr. 80/2015, behet pjese integrale e aktit te themelimit.

ORTAKU

ARTAN LILAMANI



Date : 11/12 /2018